



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:241257

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05511195

C.nr. 1008/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses H.J nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë dhe kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 1, 863.00 euro, jashtë seancës, më datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.J.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses H.J nga Gjakova, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 270 ditë pune të ja paguajë shumën prej 540.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 03.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses H.J nga Gjakova, në emër të kompensimit për udhëtim për periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 270 ditë pune të ja paguajë shumën prej 1,323.00 euro duke e llogaritur nga 70% e shumës prej 7 euro për çdo biletë (70% i 7 euro = 4.90 euro), me kamatë ligjore 8% nga data 03.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses H.J, t'i paguajë shumën prej 125.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm, refuzohet pjesa tjetër e shpenzimeve procedurale mbi shumën e gjykuara prej 125.00 euro e deri në shumën 135. 00 euro dhe atë për shumën prej 10.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësja H.J, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 03.11.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, kanë parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë dhe kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit në shumën prej 1,863.00 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësimdhënës në SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqisht, Komuna e Rahovecit, e që për periudhën e kërkuar paditëses i ka takuar e drejta e kompensimit të ushqimit në punë dhe udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 18.04.2017, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 18.04.2021 e deri më 21.11.2022 dhe atë për 270 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 09.02.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse rezulton e pavlefshme. Më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. Padia e paditësit nuk është e bazuar në asnjë bazë të vlefshme juridike, dhe nga provat e paraqitura dhe pretendimet e parashtruara, paditësi nuk ka arritur të argumentoj themelësinë e kërkesëpadisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1346/2 i datës 12.07.2023, i lëshuar nga SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqisht, Komuna e Rahovecit; kontratën e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 564/2, e datës 01.09.2017, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditëses H.J dhe vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i datës 11.10.2023, i lëshuar nga G në Gjakovë.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, si dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 1346/2 i datës 12.07.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësja H.J në periudhën kohore prej datës 18.04.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 270 ditët e punës.

Me administrimin e kontratës e punës për mësimdhënës me Nr. të protokollit 564/2, e datës 01.09.2017, të lidhur ndërmjet paditëses H.J dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka kontratë pune me të paditurën dhe e njëjta është e sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHFMU “Haki Stërmilli” në fshatin Zoqisht, Komuna e Rahovecit.

Me administrimin e vërtetimit e çmimit të biletës së udhëtimit i datës 11.10.2023, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Gjakovë - Xërxë është 2 euro në dy drejtime, në relacionin Xërxë – Rahovec është 2 euro në dy drejtime, si dhe në relacionin Rahovec - Retijë është 3 euro në dy drejtime

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi në periudhën kohore nga data 18.04.2021 e deri më datën 20.11.2022 në vendin e saj të punës ka prezantuar në 270 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësja ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”*. Në rast se shumëzohen 270 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 550 euro. Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Në rast se shumëzohen 270 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 7 euro për çdo biletë (70% i 7 euro = 4.90 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 1,323.00 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera*

për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.1008/2023, më datën 27.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.